

Banka ProCredit sh.a, Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri.

### Vesna Paunovska

Ka lindur në Shkup, më 14 Janar 1975. Ajo u diplomua si ekonomiste në Fakultetin Ekonomik - Ss. Cyril and Methodius University, në Shkup. Ajo ka marrë pjesë në disa trajnime profesionale të organizuara nga KMGP, PWC dhe ka përfunduar gjithashtu edhe Akademinë ProCredit në Veles, Maqedoni.

Zonja Paunovska është auditore e çertifikuar e Republikës së Maqedonisë. Karrierën e saj e filloi në kompaninë Ernst & Young Maqedoni, ku ka punuar në disa pozicione, përfshirë Auditues të Lartë dhe Supervizore të Auditimit. Ajo iu bashkua ProCredit Bank në Maqedoni në vitin 2007 si Drejtuese e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm. Në këtë pozicion, ajo ishte përgjegjëse për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës së Bankës, si dhe politikat dhe procedurat e departamentit. Nga muaji maj i vitit 2013 e tutje, ajo është koordinatore e Auditit të Grupit Ndërkombëtar ProCredit, me zyrat qendrore në Frankfurt, Gjermani.